

NJOFTIM PËR AUTORITETET KONTRAKTUESE DHE PALËT E INTERESUARA

Njoftohen të gjitha autoritetet kontraktuese, si dhe palët e interesuara se në bazë të Vendimit Nr. 50/2015, të datës 30. 04. 2015, të Ministrisë së Financave është emëruar Grupi Punues për hartimin e Draftit Fillestar të Projekt Ligjit për Prokurim Publik.

Grupi punues më datën 06. 05. 2015 ka mbajtur takimin e parë të punës, dhe me qëllim që ky Draft Fillestar i Projekt Ligjit për Prokurim Publik të përgatitet në mënyrë sa më profesionale nxori këtë:

KONKLUZION

Kërkohet nga të gjitha autoritetet kontraktuese të Kosovës, si dhe palët e interesuara, që grupin punues ta pajisin me propozime dhe komente, të cilat do ta ndihmonin për përgatitjen e një Projekt Ligji për Prokurim Publik sa më të kompletuar dhe të avancuar, për përmbushjen me sukses të nevojave të autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, si dhe palëve të interesuara, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit publik në Kosovë.

Të gjitha propozimet, idetë dhe komentet duhet të dërgohen deri më 24 Maj 2015, në e-mail adresën: info.krpp@rks-gov.net

Parapakisht ju falënderojmë për kontributin tuaj.